



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0456

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së OE "KOSOVA MOTORS GROUP " S H.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “FURNIZIM ME AUTOBARTËSE (MARIMANGË) PËR PK-në-Ritender” me numër të prokurimit 214/30400-25-11147-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS, më 20/08/2026, mori këtë:

Vendim

1. **Aprovohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e "KOSOVA MOTORS GROUP " S H.P.K. me nr. 2026/0456 , e datës 03/07/2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit “FURNIZIM ME AUTOBARTËSE (MARIMANGË) PËR PK-në-Ritender”, me numër të prokurimit 214/30400-25-11147-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues – POLICIA E KOSOVËS.

2. **Mbetet në fuqi** B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - POLICIA E KOSOVËS për aktivitetin e prokurimit “FURNIZIM ME AUTOBARTËSE (MARIMANGË) PËR PK-në-Ritender”, me numër të prokurimit 214/30400-25-11147-1-1-1.

3. Në përputhje me nenin 31 pika 6, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 19.12.2025. POLICIA E KOSOVËS, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit FURNIZIM ME AUTOBARTËSE (MARIMANGË) PËR PK-ne-Ritender” me nr. të prokurimit: "214/30400-25-11147-1-1-1"

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, Lloji i kontratës: Furnizim, Vlera e parashikuar e kontratës: 243,000.00 €.

Me 19.06.2026 POLICIA E KOSOVËS duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "AGS Corporation dhe Auto Kacandolli.

Me 24.06.2026, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 24.06.2026 AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 03.07.2026, OE "KOSOVA MOTORS GROUP " S H.P.K. ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2026/045, kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues KOSOVA MOTORS GROUP " S H.P.K. janë parashtruar si në vijim:

Neni 1 - Qëllimi; Neni 7 - Barazia në trajtim/ Jo-Diskriminimi; Neni 10 - Mjetet për promovimin e Transparencës Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve; Neni 60 - Kriteret për Dhënien e Kontratës

Të nderuar, duke mënjeluar përsëritjet e panevojshme të deklaratave nga ankesa e parë e bërë në OSHP e cila ankesë që e bazuar nga OSHP, ne tentojmë të japim argumentet tona nga vetëm nga momenti kur lënda është kthyer në rivlerësim ashtu siç OSHP ka dhënë urdhër. Me datë 19.06.2026, AK shpall njoftimin mbi vendimin dhe letrat standarde dhe aty kuptuam se AK e ka rekomanduar të njëjtin OE për dhënie të kontratës.

Ne kërkuam çasje në DT për arsye të verifikimit të dokumenteve për çështje të katalogut i cili prejardhjen e ka nga vet OE i rekomanduar për kontratë dhe për këtë është vërtetua edhe nga eksperti shqyrtues pranë OSHP-së dhe paneli shqyrtues poashtu. Nga AK na është bërë e ditur se janë në dispozicion dy (2) dokumente të cilat AK i ka pranuar nga dilleri maqedonas i cili e ka autorizuar operatorin ekonomik të rekomanduar për kontratë. Ne i kemi marrë nga një kopje të këtyre dokumenteve në fjalë dhe shihet se ato janë të lëshuara nga i njëjti diller maqedonas i cili pretendon se katalogu është nga prodhuesi mirëpo ne kemi konstatuar se katalogu nuk që nga prodhuesi por i bërë nga vet operatori ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet tenderik dhe me krijimin e dokumentit në fjalë nga vet OE kjo shpie drejt shkeljes së Kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale të DT pika 9.1 & 9.2-

Kërkesa 2: Katalog nga prodhuesi me përshkrim të detajuar, me të cilin është e mundur vlerësimi sipas specifikacioneve teknike të kërkuara. Vlen të potencohet se gjatë çasjes, AK ka deklaruar se nuk mund të ipen shkresat elektronike sepse konsiderohen konfidenciale dhe rastin në fjalë AK bënë shkelje të Nenit 10 konkretisht pika 3 dhe 4 sepse nuk është mundur çasja e rregullt siç LPP garanton dhe nuk ka arsye se përse të cilësohen këto dokumente konfidenciale. Për fund:

Ne deklarojmë se dilleri maqedonas bashkarisht me operatorin ekonomik të rekomanduar për kontratë kanë përgaditur dhe lëshuar deklarata në favor të tyre dhe i kanë përshtat në atë mënyrë siç atyre i konvenon. Ne deklarojmë përsëri se nuk ka katalog të ndonjë prodhuesi që nuk e ka llogon zyrtare në katalogjet të cilat lëshohen globalisht për të gjithë pa dallim me dizajn zyrtar të prodhuesit ndërsa në katalogun të cilin OE e ka ngarkuar në e-prokurimi shihet haptazi se është i krijuar nga vet operatorin ekonomik dhe kjo e bënë këtë OE të papërgjegjshëm dhe njëkohësisht AK duke mbrojtur vazhdimisht pa të drejtë këto pretendime të këtij OE në fjalë shpie drejt shkeljes së Nenit 1, Nenit 7 dhe Nenit 59 të LPP-së përfshirë poashtu edhe atë Neni 60 - Kriteret për dhënien e Kontratës

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

OE ankues nuk ka paraqitur pretendime konkrete për të gjitha nenet e përmendura, andaj Autoriteti Kontraktues (AK), në vijim, do të trajtojë vetëm pretendimet e ngritura nga operatorin ekonomik ankues.

Pretendimi ankimor i OE-së lidhur me katalogun nuk qëndron dhe është i pabazuar. AK e ka kthyer lëndën në rivlerësim dhe ka trajtuar çështjen e katalogut në përputhje me rekomandimin e ekspertit shqyrtues, duke pasur parasysh se vendimi i OSHP-së i ka dhënë besueshmëri raportit të ekspertit. Për rrjedhojë, kjo çështje është trajtuar në përputhje me rekomandimin e ekspertit dhe në bazë të kriterëve të përcaktuara në Dosjen e Tenderit (DT).

Rekomandimi i ekspertit shqyrtues ishte si në vijim:

"Eksperti shqyrtues vlerëson se dokumenti i dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë, pavarësisht marrëveshjeve dhe autorizimeve të paraqitura, nuk përbën katalog të lëshuar nga prodhuesi. Meqenëse Dosja e Tenderit ka kërkuar në mënyrë të qartë Katalog nga prodhuesi, dokumenti i ofruar nuk është katalog nga prodhuesi, por një katalog alternativ i hartuar nga vetë ofertuesi. Eksperti shqyrtues sqaron se, në këtë rast, mungon Katalogu nga prodhuesi, ashtu siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit.

Sipas Udhëzimit Administrativ nr. 002/2024 (neni 10), për sqarimin e tenderëve gjatë fazës së vlerësimit, autoriteti kontraktues ka të drejtë të kërkojë informata sqaruese në rastet kur mungon katalogu.

Prandaj, kjo çështje mund të trajtohet në rivlerësim duke kërkuar sqarime shtesë nga operatorin ekonomik, pa ndryshuar elementet thelbësore të ofertës."

Në zbatim të këtij rekomandimi, AK ka kontaktuar dhe ka verifikuar dokumentacionin me përfaqësuesin e autorizuar të Mercedes-Benz, nga i cili ka pranuar konfirmimin se katalogu i dorëzuar është origjinal. Gjithashtu, janë sqaruar edhe arsyet e paraqitjes së gjurmëve dhe të dhënave identifikuese në katalog, përmes deklaratave të dorëzuara nga përfaqësuesi i autorizuar.

Në deklaratën e parë thuhet:

"We hereby confirm that Auto Kaçandolli is an authorized dealer of Mercedes-Benz and Daimler Trucks vehicles in Kosovo. Therefore, we confirm that the catalog is original. Furthermore, we confirm that we fully support and stand behind the catalog and the information provided, as well as the offer submitted by Auto Kaçandolli."

Në deklaratën e dytë sqarohet se:

"Auto Kaçandolli është distributor i autorizuar i Mercedes-Benz dhe Daimler Trucks në Kosovë. Katalogu, specifikimet teknike të automjetit dhe oferta janë gjeneruar drejtpërdrejt nga sistemi zyrtar i konfigurimit të Mercedes-Benz. Emri i Auto Kaçandollit dhe i përfaqësuesit përgjegjës të shitjes, z. Dardan Domi, shfaqen automatikisht në dokumentet e specifikimeve si pjesë standarde e sistemit zyrtar të Mercedes-Benz. Çdo distributor i autorizuar pajiset me një llogari unike përdoruesi që përmban të dhënat e kompanisë dhe të punonjësit përgjegjës. Për këtë arsye, paraqitja e këtyre të dhënave në dokument konfirmon autenticitetin dhe origjinën e tij. Format i dokumentit është i standardizuar dhe i njëjtë për të gjithë distributorët e autorizuar të Mercedes-Benz."

Këto deklaratë janë vënë në dispozicion edhe operatorit ekonomik ankues më datë 22.06.2026, me rastin e realizimit të kërkesës për qasje në dokumente.

Po ashtu, nuk qëndron pretendimi se distributori nga Maqedonia e Veriut nuk ka të drejtë të lëshojë deklaratë. Në Dosjen e Tenderit është kërkuar autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar i prodhuesit. Për rrjedhojë, kërkesa e Dosjes së Tenderit është përmbushur, pasi deklarata është lëshuar nga distributori i autorizuar, i cili përbën edhe pikën zyrtare të kontaktit me prodhuesin.

Për këto arsye, Autoriteti Kontraktues vlerëson se pretendimi ankimor është i pabazuar dhe, si i tillë, kërkesa për rishqyrtim duhet të refuzohet.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 07.07.2026 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2026/0456, ndërsa me datë 20.07.2026 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2026/0456, me rekomandimet si në vijim:

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues aprovohet pjesërisht si e bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK të datës 19.06.2026.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK është pajtuar rreth rekomandimit të raportit të ekspertit shqyrtues, po ashtu as OE nuk është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues. Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritord lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtrirat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OEKOSOVA MOTORS GROUP " S H.P.K.eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0456 ka vlerësuar si në vijim:

Eksperti shqyrtues në pajtim me legjislacionin në fuqi ka analizuar pretendimin ankimor të ngritur nga OE ankues dhe vlerëson se OE ankues në këto ankesë, ka paraqitur vetëm një pretendim ankimor që ka të bëjë me OE të rekomanduar.

Ky pretendim në këtë ankesë lidhet me pretendimin nr.1 për OE të rekomanduar, që Operatori Ekonomik ankues e kishte në ankesën nr.317/2026.

Lidhur me këtë pretendim ankimor, që ka të bëjë me katalogun e prodhuesit, eksperti shqyrtues vlerëson se kjo çështje është trajtuar tashmë në ekspertizën dhe Vendimin e OSHP-së nr. 317/2026. Në atë rast, eksperti kishte konstatuar se dokumenti i dorëzuar nuk mund të konsiderohej katalog i prodhuesit në kuptimin e kërkesës së dosjes së tenderit, mirëpo njëkohësisht kishte vlerësuar se, në pajtim me nenin 10 të Udhëzimit Administrativ nr. 002/2024 për sqarimin e tenderëve gjatë vlerësimit, kjo mangësi mund të sqarohet gjatë fazës së rivlerësimit përmes kërimit të informatave sqaruese, pa ndryshuar përmbajtjen thelbësore të ofertës. Për këtë arsye ishte rekomanduar kthimi i lëndës në rivlerësim.

Nga dokumentacioni i ofruar si në ankesën e OE ankues, po ashtu edhe në procesverbalin e rivlerësimit të ofertave, rezulton se Autoriteti Kontraktues ka zbatuar Vendimin e OSHP-së nr. 317/2026, duke e kthyer lëndën në rivlerësim dhe duke kërkuar sqarime shtesë lidhur me katalogun e dorëzuar. Në përgjigjen e datës 15.06.2026, distributori i autorizuar ka konfirmuar se dokumenti (katalogu) i paraqitur është gjeneruar drejtpërdrejt nga sistemi zyrtar i konfigurimit të Mercedes-Benz, dhe se specifikimet dhe oferta janë origjinale, si dhe ka sqaruar se paraqitja e emrit të shitësit të autorizuar dhe përfaqësuesit përgjegjës është funksionalitet standard i sistemit dhe shërben vetëm për identifikimin e shitësit të autorizuar që e ka gjeneruar katalogun. (Dëshmia):

Pra është sqaruar se katalogu është nga sistemi i Prodhuesit, por të dhënat e shitësit të autorizuar, shfaqen në katalog për shkak të sistemit që e ka kompania Mercedes-Benz.

Rrjedhimisht, eksperti vlerëson se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me udhëzimet e dhëna në Vendimin e OSHP-së nr. 317/2026, duke administruar sqarimet e nevojshme dhe duke eliminuar paqartësitë që kishin ekzistuar lidhur me origjinën e katalogut. Në këto rrethana, konstatohet se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me vendimin e OSHP-së dhe me dispozitat e legjislacionit të prokurimit publik lidhur me këtë çështje.

Për rrjedhojë, edhe pse pretendimi ankimor vlerësohet pjesërisht i bazuar në kuptimin që çështja kishte kërkuar sqarim, ky sqarim është siguruar gjatë rivlerësimit në zbatim të Vendimit të OSHP-së nr. 317/2026. Si rezultat, eksperti vlerëson se ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar ndërsa Njoftimi Vendimi i Autoritetit Kontraktues të datës 19.06.2026, duhet të mbetet në fuqi.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktiviteti të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues mendimet e tij janë të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuar nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se ankesa e OE ankues duhet aprovuar si ojesërisht e bazuar, por e pamjaftueshme për të ndryshuar epilogun përfundimtar të vendimmarrjes nga AK. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër dhe pa nevojë që të njëjtat të përsëriten sërish, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit, ka vendosur të mbetet në fuqi njoftimi për dhënje të kontratës Autoritetit Kontraktues POLICIA E KOSOVËS..

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me padi mund t'i drejtohet Gjykatës Administrative në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm për anulim të vendimit në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - POLICIA E KOSOVËS**
- **OE - "KOSOVA MOTORS GROUP " S H.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: